



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 322/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Viti, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) dega në Sllatin e Epërme, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pasafatshme ankesa Anr.322/2017, të datës 13.06.2017, parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Viti, për shkak të parregullësive gjatë procesit të votimit me datë 11.06.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13 qershor 2017, nga subjekti politik PDK dega në Viti me të cilën pretendon se në vendovotimin VV nr.2607d/01 Në Sllatin të Epërme gjatë shënimit të FRPP-së janë ngatëruar votat e kandidatëve me numërin 79 dhe numërin 78, prandaj kandidati me numër 79 i ka pasur 54 vota kurse gabimisht ju kanë shënuar kandidatit me numër 78. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që ta bëjë përmirësimin e votave mes dy kandidatëve. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 kopje të formularëve të rezultateve zgjedhore.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmerisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5.3 të Rregullorës Nr 02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 13.06.2017. Nga përmbajtje e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e

ankesës ka qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e tij e ka parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullorës Nr 02/2015 lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 322/2017 më datën 14.06.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.